

RRITET ROLI I PËRFAQËSUESVE NGA BIZNESI NË KI

Me VKM Nr. 335 datë 22.05.2019 “Për Disa Ndryshime në VKM Nr. 294, datë 08.04.2015, “Për Krijimin e Këshillit të Investimeve”, u fuqizua roli i përfaqësuesve nga biznesi në Këshillin e Investimeve (KI). Numri i anëtarëve në KI si përfaqësues të biznesit u rrit nga 6 (3 dhoma tregtie/shoqata biznesi dhe 3 kompani) në 8 (6 dhoma tregtie/2 kompani). Ky ndryshim u bë në funksion të përfshirjes të më shumë zërave përfaqësues nga komuniteti i biznesit për problematikat e klimës së investimeve në vend dhe prioritizimin e zgjidhjeve të propozuara për adresimin e tyre.

Përfaqësuesit nga biznesi në KI janë:

- 2 anëtarë nga radhët e dhomave të tregtisë dhe industrisë me *status të përhershëm* në KI.
 - (i) Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
 - (ii) Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
- 4 anëtarë nga radhët e shoqatave të biznesit me *mandat 2 vjeçar*.
 - (iii) FIAA- Shoqata e Investitorëve të Huaj
 - (iv) AmCham- Dhoma Amerikane e Tregtisë
 - (v) DIHA- Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë
 - (vi) Confindustria Albania
- 2 anëtarë *ad-hoc* (kompani) të cilët do të caktohen rast pas rasti në bazë të tematikave specifike që do të diskutohen në mbledhjet e KI.

Përzgjedhja e dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit në formulën e re të anëtarësisë në KI, ka mbajtur në konsideratë krijimin e një balance optimale të përfaqësimit midis rreth 98 organizatave që e kanë fushën e veprimtarisë të lidhur me klimën e biznesit në vend dhe gërshtetimin midis:

- a. dhomave të tregtisë dhe industrisë të krijuara me ligj dhe shoqatave si përfaqësuese të grupeve apo segmenteve të caktuara të biznesit; shoqatave përfaqësuese të biznesit shqiptar dhe atij të huaj;
- b. sektorëve të biznesit të përfaqësuar nga secila shoqatë, numrit të anëtarësisë, shtrirjes gjeografike,
- c. indeksit të vlerësimeve të klimës së biznesit në vend dhe materialeve të tjera të publikuara prej tyre;
- d. nivelit të organizimit dhe strukturimit të tyre;
- e. angazhimit dhe kontributit të dhënë në kuadër të KI dhe/ose Focus Group të organizuara nga Sekretariati;
- f. nëse kanë qenë ose jo më parë anëtarë në KI;

Nisur nga sa më sipër dhe mbi bazën e kriterëve objektive, më poshtë është një profil i shkurtër i secilit anëtar nga radhët e komunitetit të biznesit në KI:

1. Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)

- **Krijimi:** 1994
- **Anëtarësia:** 20 Dhoma Tregtie dhe Industrie
- **Profili i anëtarëve dhe sektorët e biznesit:** Të gjithë sektorët dhe llojet e bizneseve
- **Shtrirja gjeografike:** Kombëtare
- **Anëtarësia dhe kontributi deri më sot në KI:** Anëtar i KI periudha 2018-2019
- **Publikime:** N/A

2. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë

- **Krijimi:** 1926
- **Anëtarësia:** 99 Biznese (përditësimi fundit: qershor 2019)
- **Profili i anëtarëve dhe sektorët e biznesit:** Industri, shërbim, ndërtim, tregti
- **Shtrirja gjeografike:** Tiranë
- **Anëtarësia dhe kontributi deri më sot në KI:** Anëtar i KI periudha 2015-2016
- **Publikime/Te tjera** – aktivitete dhe iniciativa kombetare dhe rajonale, faqja e internetit

3. FIAA- Shoqata e Investitorëve të Huaj

- **Krijimi:** 2000
- **Anëtarësia:** 83
- **Profili i anëtarëve dhe sektorët e biznesit:** Investitorët e huaj/ vendas në Energji, Telekomunikacion, Burime Natyrore, etj.
- **Shtrirja gjeografike:** Kombëtare
- **Anëtarësia dhe kontributi deri më sot në KI:** Anëtar i KI periudha 2015-2016 dhe 2018-2019, pjesëmarrës aktiv në fokus grup dhe anketa
- **Publikime/Te tjera :** White Book dhe business climate Index, konferenca kombetare investitorësh të huaj

4. AmCham- Dhoma Amerikane e Tregtisë

- **Krijimi:** 2000
- **Anëtarësia:** 200
- **Profili i anëtarëve dhe sektorët e biznesit:** Investitorët e huaj/vendas në Banking, Energji, Konsulencë, Telekomunikacion etj.
- **Shtrirja gjeografike:** Kombëtare
- **Anëtarësia dhe kontributi deri më sot në KI:** Anëtar i KI periudha 2016-2017, bashkëpunues në anketën dhe fokus grup me KI
- **Publikime/Te Tjera:** AmCham Business Index, Revista “The Advantage”, forume biznesi, etj.

5. DIHA- Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë

- **Krijimi:** Viti 2008
- **Anëtarësia:** rreth 90 kompani
- **Profili i anëtarëve dhe sektorët e biznesit:** Investitorët e huaj
- **Shtrirja gjeografike:** Kombëtare
- **Anëtarësia dhe kontributi deri më sot në KI:** Jo anëtar, bashkëpunues në anketa, fokus grupe
- **Publikime:/Te tjera** Anketa periodike e klimës së biznesit

6. Confindustria Albania

- *Krijimi: 2016*
- *Anëtarësia: 106*
- *Profili i anëtarëve dhe sektorët e biznesit: Investitorët e Huaj/Transport dhe Logjistikë, Shërbime Financiare, Mekanikë dhe Inxhinieri etj.*
- *Shtrirja gjeografike: Kombëtare dhe nderkombetare*
- *Anëtarësia dhe kontributi deri më sot në KI: Jo anëtar por bashkëpunues në fokus grup, në anketa të KI,*
- *Publikime/Te tjera – publikime në fushën e energjisë, klimes së biznesit, forume investitorësh etj*

KI si një platformë gjithëpërfshirëse është e angazhuar sikurse deri më sot të bashkëpunojë me të gjitha shoqatat dhe grupet e interesit, ekspertët dhe organizatat e tjera që merren me klimën e investimeve/biznesit të cilët mund të përfaqësohen në KI me statusin e vëzhguesit ose në nivel teknik në Grupet e Punës/Focus Group të organizuara nga Sekretariati i KI.

Shënim: Informacioni në këtë dokument është bazuar në informacione të publikuara në faqet e internetit të shoqatave të biznesit/dhomave të tregtisë dhe/ose konfirmuar nga ata vetë zyrtarisht pranë Sekretariatit të KI.